

VENDIM
Nr. 518, datë 21.12.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
BERAT-KUÇOVË SHA

(ndryshuar me vendimin nr. 483, datë 14.10.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 21.12.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë, me shkresën nr. 1524 prot., datë 10.12.2021, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së për rinovim licence të shoqërisë, për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik, dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR-ja) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Berat–Kuçovë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria UK Berat–Kuçovë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 132 163 banorë të Bashkisë Berat–Kuçovë;

b) Drejtuesja teknik, znj. Aleksandra Kllapi, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknike, në vitin 1986 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat–Kuçovë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Berat–Kuçovë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. me (NUIS J62903166T), në kategoritë:

- a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor – Pelivan Sinaj;
- b) *Drejtues teknik: Evis Allajbe.*

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. është Bashkia Berat–Kuçovë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani